

**MARRËVESHJE TRANSFERIMI TË PJESËVE TË KAPITALIT
TË SHOQËRISË “AB VIZION” SH.P.K.**

Në Tiranë, sot më 05/02/2024, palët e kësaj Marrëveshjeje ranë dakort si më poshtë:

Shitësi:

- **Z. Bashkim Teqja**, shtetas shqiptar, lindur më 10/09/1948, në Tiranë, mbajtës i Dokumentit të Identifikimit me Nr. Personal E80910087R madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
(më poshtë referuar “**SHITËSI**”)

Dhënëse Pëlqimi:

- **Zj. Bahrije Teqja**, shtetase shqiptare, lindur më 09/09/1953, në Durrës, madhore e me zotesi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e Dokumentit të Identifikimit me Nr. personal F35909014O, në cilësinë e bashkëshortes së **Z. Bashkim Teqja**.

Blerësi:

- **Z. Gazment Teqja**, shtetas shqiptar, lindur më 12/11/1979, në Tiranë, mbajtës i Dokumentit të Identifikimit me Nr. Personal H91112048M madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
(më poshtë referuar “**BLERËSI**”)

MEQËNËSE:

- A. Shitësi zotëron 100% të Kapitalit të Shoqërisë “**AB VIZION**” Sh.p.k, një shoqëri ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me **NIPT M22009029L**, me seli në: Rruga “Kostandin Kristoforidhi”, Njesia Bashkiake nr.2, Godina nr.4, Kati 4, 1000, Tiranë, (“Shoqëria”), me një kapital prej 1.000.000 (një milion) Lek, i përbërë nga 1 kuotë.
- B. Blerësi dëshiron të blejë 100 % të Kapitalit të Shoqërisë të zotëruar nga Shitësi në shoqërinë e lartpërmendur “**AB VIZION**” Sh.p.k siç përcaktohet në këtë marrëveshje.
- C. Në përputhje me **Ligjin Nr. 9901**, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe nenet e Statutit të Shoqërisë, Ortaku i vetëm i shoqërisë **Z. Bashkim Teqja** ka marrë vendimin përkatës për transferimin tek Blerësi **Z. Gazment Teqja** të kapitalit si më sipër.

PER SA ME SIPER, palët bien dakort si më poshtë:

- 1. Shitësi pranon se ka marrë nga Blerësi në mënyrë të plotë të gjithë çmimin e blerjes të rënë dakord në vlerën nominale të kuotës, prej 1.000.000 (një milion) Lek dhe për këtë arsye transferon këtu 100% të Kapitalit të zotëruar nga Shitësi **Z. Bashkim Teqja** tek Blerësi **Z. Gazment Teqja**.
Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se 100% e kuotave të kapitalit që transferohet këtu është në pronësinë e tij të plotë ligjore dhe të lirë nga barra, hipoteke apo pengje.
- 2. Blerësi pranon pronësinë e 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë, duke njohur gjendjen e Shoqërisë dhe bien dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i Kuotave brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar.

3. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, ortakë të shoqërisë dhe pjesët e kapitalit të zoteruara prej tyre në shoqërinë “AB VIZION” Sh.p.k. do të jenë:

- **Z. Gazment Teqja** - zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë.

4. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të kuotës objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

DHËNËSE PËLQIMI

Zj. Bahrije Teqja bashkëshorte e **Z. Bashkim Teqja**, ortak në shoqërinë “AB VIZION” Sh.p.k dhe bashkëpronare në kuotën që **Z. Bashkim Teqja** zotëron në shoqërinë “AB VIZION” Sh.p.k., për efekt të martesës deklaroi se është dakord që 100% të kuotave të kapitalit, objekt i kësaj kontrate, në pronësi të bashkëshortit të saj, t’i shiten **Z. Gazment Teqja**.

Dhënësja e pëlqimit **Zj. Bahrije Teqja**, deklaroi se nuk ka asnjë pretendim lidhur me këtë vendimmarrje të bashkëshortit të saj për shitjen e 100% të kuotave të kapitalit që zotëron në shoqërinë “AB VIZION” Sh.p.k dhe nuk do ketë asnjë pretendim në të ardhmen lidhur me këtë shitje.

Kjo Marrëveshje u hartua në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, me vlerë të barabartë ligjore.

Marrëveshja bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

Marrëveshja u lexua nga palët, u gjend e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre.

SHITËSI

BASHKIM TEQJA



DHËNËSE PËLQIMI

BAHRIJE TEQJA

Bashkëshortja e Shitësit



BLERËSI

GAZMENT TEQJA

